



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

Lënda: Kthim përgjigje suajës datë 20.09.2022

ZNJ. JONA KARAPINJALLI

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 20.09.2022, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, nëpërmjet së cilës kërkonti t'ju vendosen në dispozicion dokumenta lidhur me procedurën e konkurimit për pozicionin me kod shpallje: #4195- Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, në Drejtorinë e Analizave dhe Projekteve, në Komitetin për Pakicat Kombëtare - kategoria: III-a/1, në bazë të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", ju informojmë se:

Referuar kërkesës suaj në lidhje me fazën e testimit me shkrim për procedurën e konkurimit me kod 4195, ju bëjmë me dije se në nenin 14 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" përcaktohet:

"1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;

b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar."

Referuar pikës 4 të nenit 14 të sipërcituar sqarojmë se, shpërndarja dhe publikimi i pyetjeve të testeve me shkrim, në procedurat e konkurimit në shërbim civil, do cënonte bankën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

unike të pyetjeve që DAP përdor në formulimin e këtyre testimeve. Në këto kushte, për shkak të natyrës së dokumentacionit të kërkuar dhe praktikës së ndjekur në raste të tjera të ngjashme, me qëllim vënien në dispozicion të këtij informacioni, është caktuar një takim midis jush dhe anëtarëve të Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, *për ditën e hënë, datë 19.09.2022, ora 13:30, në ambientet e Departamentit të Administratës Publike*. Rezulton se ditën dhe orën e përcaktuar ju nuk jeni paraqitur në takim. Megjithatë, ju jeni e mirëpritur që të aksesoni dokumentacionin e kërkuar pranë ambienteve të Departamentit të Administratës Publike në vijim.

Ndërkohë sjellim në vëmendjen tuaj se, kjo mënyrë e ofrimit të aksesit në informacion/dokumentacion publik, e përzgjedhur nga DAP dhe anëtarët e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, garanton të drejtën e individit për informim, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", si dhe jurisprudencën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. 3085, data 25.11.2020 është shprehur: *"Gjykata e vlerëson se, informacioni i dhënë nga pala e paditur DAP në bazë të kërkesës së palës paditëse I.O. ka qenë i plotë e në përputhje me parashikimet e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Kështu palës paditëse i është dhënë informacioni i kërkuar (...)*.

Përsa i përket kërkesës suaj për dokumentin që provon lidhjen e barkodit me emrin e kandidatit, Departamenti i Administratës Publike sjell në vëmendje se, ditën e testimit me shkrim, secili kandidat pjesëmarrës pajiset me barkodin unik në fletën e testimit (fleta e kuqe), në prezencën e tij. Në momentin e vendosjes së këtij barkodi, kandidati nënshkruan përbri emrit të tij, në listën emërore nga ku tërhiqet barkodi personal. Në vijim, për të bërë lidhjen e kandidatit me tezën e plotësuar prej tij përdoret një pajisje specifike e teknologjisë së informacionit, e cila bën skanimin e fletës së kuqe me barkodin përkatës dhe lidhjen e tij me numrin unik të identifikimit për secilin kandidat.

Gjithashtu, bashkëlidhur me këtë shkresë do të gjeni një kopje të njësuar të:

1. Urdhrit nr. 413, datë 07.09.2022 të DAP për krijimin e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë për pozicioni #4195- Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, në Drejtorinë e Analizave dhe Projekteve, në Komitetin për Pakicat Kombëtare - kategoria: III-a/1 (1 fletë);
2. Formularit individual të vlerësimit të znj. Jona Karapinjalli, për procedurën e konkurimit me kod 4195, në të cilin jepet informacion i detajuar mbi vlerësimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

kandidatit në secilën fazë të konkurimit (jetëshkrimi, intervista e strukturuar me gojë, testimi me shkrim) (1 fletë);

3. Procesverbalit të datës 03.10.2022 të Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, në të cilin gjeni informacion mbi listën e pyetjeve dhe përgjigjeve të sakta në intervistën e strukturuar me gojë, si dhe transkriptimin e intervistës së strukturuar me gojë për procedurën e konkurimit me kod 4195, për kandidatin znj. Jona Karapinjalli (13 fletë).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,